



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Nr. _____ Prot.

Berat, më 11_/ 09/ 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndertimin e kendit sportiv ne shkollen Otlak

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): tapete gjimnastikore – 34721000-5 , pajisje per sporte ne fusha 37452000-1, lojra dhe lodra; zbavitese ne natyre, bar artificial -39293300-5, rrjeta metali 44313000-7, punime betoni – 45262300-4

VLERA E FONDIT LIMIT: : 3,247,711 (tre milion e dyqind e dyzete e shtate mije shtateqind e njembedhjete) lek pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

përcaktimeve të VKM nr.285, date 19.05.2021, neni 43, pika 4 (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, behet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 2. Situacionin përfundimtar të objektit;
 3. Fatura tatimore përfundimtare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - **N.P - 1 A Punime gjurmimi në tokë;**
 - **N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;**

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur ne SPE. Per piken *NS-1 A eshte bazuar ne zerat e preventivit per gërmim themelesh ne funksion te ndertimit te bazamentit te fushes sportive.*

N.S - 8 *A eshte bazuar ne zerat e preventivit per punime betoni arme te bazamentit te fushes sportive dhe ndertimit te konstruksionit metalik rrethues te fushes sportrive*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë te certifikuar sipas profesioneve, te pakten si me poshte:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Hidraulikë	1 (nje)
- Elektracistë	1 (nje)
- Saldator / Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	2 (dy)
- Hekurkthyes	2 (dy)
- Puntore te thjeshte ndertimi	2(dy)

- Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten deshmite/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.
- Specialistet e sipercituar sipas profesioneve, duhet të jenë të pajisur gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Shenim: Per kete pike 2.3.5 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

- **Hekurkthyesit** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hekurit, referuar zërave të preventivit të punimeve
- **Saldator / Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Elektriçisti** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve,
- **Hidrauliket** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve ku përfshin sistemin e drenazhimit, vendosjes së kunetë + zgarë dhe shkarkimin e ujrave sipërfaqësor.
- **Punëtorë të thjeshtë ndertimi** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonit ku përfshin derdhjen, nivelimin, kurimin të shtresës së betonit. Gjithashtu janë të nevojshëm për përgatitjen e kantierit pastrimin e bimesisë dhe punime të rifinitures së shtresës përfundimtare të fushës sportive.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **9 (nente) punonjës**.

- Vërtetimi të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2023**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2023**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Shenim: Per kete piken 2.3.3. te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

2.3.7 Operatoret ekonomik duhet te paraqesin dokumentacionin perkates per mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates,(sipas formularit te vetedeklarimit) si me poshte:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamioncinë me kapaciteti 3-5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinxh/autokulle me koshe	1 copë	Pronësi ose me qera
Mini Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

- Kokore, minimum 9 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimum 2 copë.
- a) Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 2 copë
- b) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- c) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- d) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- e) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- g) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Shenim: Per kete piken 2.3.4. te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- *Kamioncinë me kapaciteti 3-5 ton e nevojshme për transportin e inerteve që nxirren nga germimi I themeleve dhe pastrimit të territorit.*
- *Autobetoniere për transportin e betonit nga fabrika në kantier*
- *Vibrator betoni për ngjeshjen e konstruksioneve b/a*
- *Saldatrice për saldimet e nevojshme në montimin e konstruksionit metalik rrethues të fushes.*
- *Autovinxh/autokulle me kosh për tju ardhur në ndihme salduesve në montimin e konstruksioneve metalike në lartësi.*
- *Mini Eskavator me goma për germimin e themeleve të bazamentit të fushes.*

2.3.8. Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Relacion Teknik dhe specifikime Teknike “Ndertim I terrenit sportiv ne shkollen 9-vjecare Otlak” Korrik 2023 17 | P a g e • Zerat e rradhitur në përmbajtje, janë pjesë e pershkrimeve te detajuara te vizatimeve teknike te bera nga specialistet e fushes si dhe specifikime te tjera te mundshme te kategorive te ndryshme punimesh. • Standartet e përdorura në këtë ‘dokumentacion nuk kanë qenë mbeshtetur vetëm në vizatimet por dhe në manualet ligjore dhe libra te tjere keshillues si: • LIGJ nr. 8402, datë 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” • VKM nr. 68, datë 12.02.2001 për “Miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”. • Kushtet teknike te zbatimit, LIDHJA Nr. 2 bashkengjitur kesaj VKM, EuroCode EC 1, 2 etj • Gjithashtu, ne hartimin e specifikimeve teknike eshte marre parasysh pozicionimi I objektit, gjendja ekzistuese, impakti ne komunitet, kategoria e frekuentuesve qe do te shfrytezojne kete ambjent, siguria dhe risqe te tjera.